



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2023



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i III-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023

Më 27.06.2023

Në takim prezantuan:

Sabedin Vishi, Nënkyetar i Komunës

Zahir Doda, Drejtorja e Arsimit

Halim Shehu, Stacioni i Policisë-Kaçanik

Fatmir Qaka, EVSB

Shemsedin Abazi-KLSP

Elmihane Malsiu-HANDIKOS

Bujar Bajra-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

Ylber Tusha-Përfajqsuesi i Bizneseve

Fidaim Fazliu-KBI

Naim Hysa-Kryqi i Kuq Komunal

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Menduh Krasniqi-Inspektorati Komunal

Mbledhjen e kryesoi Nënkryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës :

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Përgatitjet për sfidat eventuale gjat sezonit verorë
- 4.Të ndryshme

1.Procesverballi u miratua nga të pranishmit

2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut

Për gjendjen e sigurisë në Komunën tonë raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë

Halim Shehu i cili tha se situata e sigurisë në periudhën në mes të dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile.

Gjithsejtë kemi pasur 69 raste ku prej tyre 5 janë vjedhje të rënda,dëmtim prone 2 raste,dhunë në familje 5 raste, dëmtim prone 2 raste, kanosje 9 raste , degradim i ambientit një rast, ngacmim seksual një rast, lëndime trupore 15 raste , lëndime të rënda trupore një rast , ndërhyrje në sistemin kompjuterik një rast , posedim i lëndëve narkotike një rast, posedim i armëve të zjarrit tri raste , pengim i personit zyrtarë në detyrë një rast, aksidente zjarri dy raste, sulme një rast, tentim vrasje një rast, mashtrim një rast, armëmbajtje pa leje 4 raste , asgjësim apo heqje e instalimeve publike dy raste dhe kundërveprim i paligjshëm një rast .

Për shkak të situatës në Veriun e Kosovës stafi policorë tek ne është zvogëluar dhe ne po mundohemi që me këto kapacitete që kemi të mbulojmë çdo gjë sa i përket sigurisë . Gjendja më alarmante është në pjesën e Parkut Nacional që në masë të madhe është duke u dëmtuar nga keqbërësit.

Paraprakisht për sezonin verorë ne kemi bërë një plan operativ ku si prioritet do ti kemi trotuaret, parkingjet, gastronominë dhe zjarret që besoj se me kthimin e stafit policorë nga Veriu i Kosovës besoj se do ta realizojmë këtë plan.

Nënkryetari:siq e dini edhe ju pjesa e Parkut Nacional menagjohet nga niveli qendrorë dhe ne si institucion përmes mekanizmave që kemi jemi munduar që përmes njoftimeve dhe kërkesave të ndryshme që i kemi bërë nivelit qendrorë për një menagjim më të mirë të kësaj pjese gjendja nuk ka ndryshuar për të mirë dhe as që kemi pasur ndonjë përgjigje prej tyre.

Parku Nacional është një zonë që i përket territorit të komunës tonë dhe ne duhet të gjejmë forma për pengimin e dëmtimit të kësaj pjese përmes kontrollave policore edhe pse po dihet se një pjesë e stafit policorë është i angazhuar në Veriun e Kosovës.

Halim Shehu: vitin e kaluar kemi arritë që të kapim keqbërësit edhe përmes përgjimeve telefonike por që dënimet që u janë dhënë kanë qenë shumë të ulta dhe po të njetit prap kanë vazhduar me këtë aktivitet. Për keqardhje është mosbashkëpunimi i akterëve në parandalimin e kësaj dukurie duke i përfshirë edhe qytetarët.

Menduh Krasniqi: gjendja e Parkut Nacional vërtet është alarmante dhe ne si inspektorat me kohë kemi bërë njoftim dhe kërkesë nivelit qendrorë për të reaguar por që deri më tani nuk ka as përgjigje po as ndonjë veprim tjetër për të përmisuar gjendjen. Ne po mundohemi që përmes inspektorëve të kontrollojmë disa pika por që nuk po kanë efekt.

Zahir Doda: sa i përket qështjes së mbrojtjes së pyjeve mendoj se mungon vetdijsimi i qytetarëve dhe i shoqërisë në përgjithsi ngase vet ne po i shërbejmë keqbërësve duke ua blerë masën drusore.

3. Përgatitjet për sfidat eventuale gjat sezonit verorë

Bujar Bajra: Agjensioni për Emergjencë na ka rekomanduar gjitha komunave për të marrë disa masa të domosdoshme si: evidentimin e zonave potenciale për vërshime me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie natyrore. Si masë paraprake na kanë rekomanduar që të përcjellim ngritjen e nivelit të lumenjëve, pastrimin e shtretërve të lumenjëve dhe përrockave, puseve të ujit, miëmbajtjen e kanaleve të ujërave atmosferik, kontrollimin e qëndrueshmërisë së urave dhe pastrimi i hapsirave ujore për rreth urave. Ne si komunë me kohë kemi marrë masa duke i futur të gjithë përrenjtë në shtrat ku rezultati është evident ngase nuk kemi pasur ndonjë vërshim që ka krijuar probleme. Problemi aktual është tek ujrat atmosferik dhe ato fekale ku shumica e shtëpive i kanë të përbashkta dhe ndodhë që të na paraqiten problematika të ndryshme.

Sa i përket situatës me zjarre gjendja ka qenë e menagjueshme dhe nuk kemi pasur ndonjë rast të kësaj dukurie falë edhe kushteve atmosferike që kanë qenë me shi.

Kemi marrë të gjitha masat që na përkasin neve si njësit emergjent duke bërë njoftime në çdo hapsirë për të parandaluar dukurinë e zjarreve ngase hyjmë në një sezonë ku edhe mund të kemi zjarre. Gjithashtu ne jemi edhe në kontakt edhe me administratorë të fshatrave ku bisedojmë për ngritjen e vigjilencës në popullatë për parandalimin e zjarreve.

Fatmir Qaka: nga takimi i kaluar është kërkuar edhe paisja e institucioneve publike me aparate për fikjen e zjarrit dhe mua po më intereson të dijë se a është bërë ndonjë hap në këtë drejtim.

Bujar Bajra: ne si sektor kemi kërkuar nga Drejtoria e Administratës që të bëjnë një listë të përgjithshme për të gjitha objektet publike duke përfshirë edhe shkollat me qëllim që të hapet një tender i përbashkët dhe ne jemi në pritje të përpilimit të kësaj liste.

5. Të ndryshme

Shemsedin Abazi: dua të ngris tri shqetësime ku dy janë në rrugën „Idriz Seferi” e që kanë të bëjnë me ndriqimin publik që ka një kohë të gjatë që nuk funksionon dhe askush nuk është interesuar që të i rregulloj dhe shqetësimi tjetër është kanalizimi ku si pasojë e dëmtimit të tij kudërmon një erë shumë e keqe.

Në fillim të Bulevardit „Ismajl Raka” po zhvillohet një shpejtësi e madhe e automjeteve që po paraqesin rrezik për këmbësorë dhe dua të pyes se a ka mundësi që në këtë pjesë të ndërtohen pengesa apo polic të shtrirë për të evituar këtë shpejtësi të automjeteve.

Nënkryetari: në rrugën „Idriz Seferi” sa i përket ndriqimit publik është kompania që e mirëmbanë dhe duhet të njoftohet ndërsa sa i përket kanalizimeve dhe ujrave që krijohen në këtë pjesë me sa e di unë është intervenuar dhe duhet të shikohet se ku qëndron problemi që këto ujra dalin vazhdimisht. Në fillim të Bulevardit „Ismajl Raka kemi menduar për një rrethrotullim dhe jemi duke punuar me expert se a është i mundur ky rrethrotullim apo jo.

Halim Shehu: një shqetësim i madh për ne si polici dhe si shoqëri në përgjithsi është mosfunksionimi i kamerave të sigurisë që për ne është një sfidë ngase mosfunksionimi i tyre po na e vështirson punën tonë. Ndonjëher ne po i shfrytëzojmë disa kamera të lokaleve private por që për prokurorinë nuk janë edhe aq bindëse.

Nënkryetari: vërtetë është një brengë mosfunksionimi i kamerave të sigurisë në qytet por që ende nuk po e dijmë se kush duhet të mirret me menagjimin e këtyre kamerave.

REKOMANDIMET

1. Të ju bëhet presion më i madh nivelit qendrorë për një menagjim më të mirë të pjesës së Parkut Nacional apo të gjindet një formë për ruajtjen e kësaj pjese nga keqbërësit.
2. Të vetëdijsohen qytetarët për dhënje të informacioneve për parandalim të dukurive negative .
3. Një koordinim më i mirë i institucioneve të sigurisë në parandalimin e dukurive negative në shoqëri
4. Të rritet gadishmëria për sfidat që mundë ti kemi gjat sezonit veror lidhur me zjarret
5. Të mirren në konsideratë rekomandimet e nivelit qendrorë për të punuar në preventivë për të ju shmangur pasojave që mundë të ndodhin në rast të ndonjë fatkeqsie natyrore.

Kryesuesi: Nënkryetari i Komunës

z. Sabedin Vishi



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka